

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-26-3076-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Paisje për Rezictensen Antimikrobike**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Interlab SH.P.K.
NUI	601678008
Adresa	Rr. Lidhja e Pejës Nr.75
Vendi	FushëKosovë
Kodi postar	12000
Numri Telefonit	+38344517811
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Betim Sadriu
Adresa elektronike	interlab.shpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	15.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot 2 - Teste rapide me ndjeshmëri dhe specificitet të lartë për zbulimin e antigjenit të Streptococcus pyogenes

Data e publikimit të tenderit B05: 05.05.2026

Proces verbali B12: 29.05.202

Vendimi B58- 29.06.2026

Kërkesë për rishqyrtim për LOT2: 06.07.2026

Vendimi i kërkeses për rishqyrtim për LOT2: 07.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Ne, në cilësinë e Operatorit Ekonomik, kemi marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Pajisje për Rezistencën Antimikrobike", me numër të prokurimit 206-26-3076-1-2-1, në kuadër të të cilit kemi dorëzuar ofertë për Lotin 1 dhe Lotin 2.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ne, në cilësinë e Operatorit Ekonomik ankues, më datë 06.07.2026 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), të publikuar në platformën e e-Prokurimit.

Më datë 07.07.2026, përmes platformës së e-Prokurimit, kemi pranuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin është refuzuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim si e

pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ JoDiskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi,

Vlerësimi dhe Krahësimi i

Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e

Kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike

dhe/ose Profesional

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, Interlab SH.P.K., në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Pajisje për Rezistencën Antimikrobike – LOT 1 dhe LOT 2”, me numër prokurimi 206-26-3076-1-2-1, parashtrojmë këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, të datës 07.07.2026, përmes të cilit është refuzuar si e pabazuar kërkesa jonë për rishqyrtim dhe është vërtetuar Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 29.06.2026.

Më datë 29.06.2026, përmes Njoftimit B58, jemi informuar se për LOT 2 është rekomanduar për dhënie të kontratës Operatori Ekonomik CORTEX Healthcare L.L.C.. Përmes letrës standarde B46 për tenderuesit e pasuksesshëm, jemi njoftuar se oferta jonë është vlerësuar si e përgjegjshme dhe se i plotëson kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, mirëpo nuk është rekomanduar për kontratë me arsyetimin se nuk ka qenë oferta me çmimin më të ulët.

Pas pranimit të njoftimit, më datë 29.06.2026 kemi kërkuar dhe kemi realizuar qasje në dokumentacionin e ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar. Nga shqyrtimi i

dokumentacionit kemi konstatuar se OE CORTEX Healthcare L.L.C. nuk e përmbush kërkesën për aftësinë teknike dhe profesionale, sipas së cilës operatori ekonomik duhej të dëshmonte se kishte përfunduar me sukses, gjatë tre viteve të fundit, kontrata të ngjashme në vlerë të përgjithshme prej së paku 40,000.00 euro.

Lista e kontratave të realizuara

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Numri i telefono Blerësit
1	Furnizim Rt-PCR dhe reagent për HPV	20.10.2024	14.11.2024	7,800.00 E	Ambulanta Mikrobiologjike Mikro-Path	dr_oliana@hotmail.com	049198215
2	Furnizim me pajisje laboratorike	04.05.2025	23.05.2025	11,500.00 E	LABBIOHEM medicallaboratory	Labbiohem11@gmail.com	049111677
3	Furnizim me pajisje laboratorike	05.05.2025	23.05.2025	6,000.00 E	N.SH Ndrçimi-RM2	ramushmahmutaj@hotmail.com	049222406
4	Furnizim me pajisje laboratorike	20.05.2025	16.06.2025	8,200.00 E	Laboratori VITA	Vitalabcr3@outlook.com	048264340
5	Furnizim me pajisje laboratorike	19.05.2025	17.06.2025	4,200.00 E	Laboratori KRE	Lab_kret@hotmail.com	044533076
6	Furnizim me pajisje laboratorike dhe reagent	20.03.2026	16.04.2026	15,000.00 E	N.SH Poliklinika VEDI	Poliklinika ved@outlook.com	049171046
7	Furnizim Rt-PCR dhe Minicentrifuge	20.03.2026	22.04.2026	6,500.00 E	Burim Vehapi B.I	Dialab ks@gmail.com	044187581
8	Furnizim me pajisje laboratorike dhe reagent	04.05.2026	26.05.2026	5,000.00 E	N.SH BIOENG	N/A	048366264

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____ CORTEX Healthcare L.L.C. _____

Vula _____



Për këtë arsye, më datë 06.07.2026, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke paraqitur në mënyrë të qartë dhe të argumentuar mangësitë e dokumentacionit të OE të rekomanduar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të datës 07.07.2026, e ka refuzuar kërkesën tonë, duke u kufizuar në konstatimin e përgjithshëm se OE i rekomanduar ka paraqitur kontrata në vlerë totale prej 64,200.00 euro dhe se kontratat janë “të lëmisë së ngjashme dhe shumë të përafërta”.

Konsiderojmë se ky arsyetim është i pamjaftueshëm, i pabazuar në përmbajtjen konkrete të dokumenteve dhe nuk u përgjigjet pretendimeve tona ankimore për arsyet në vijim:

1. AK nuk e ka shqyrtuar natyrën konkrete të kontratave të paraqitura

Në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi argumentuar se kontratat e evidentuara në listën e OE CORTEX me numrat 2, 4, 5 dhe 7 kanë për objekt furnizimin me pajisje laboratorike ose minicentrifugë. Objekti i LOT 2 lidhet kryesisht me materiale laboratorike dhe reagjentë shpenzues, ndërsa pajisjet kapitale laboratorike nuk kanë të njëjtën natyrë, mënyrë përdorimi, cikël furnizimi dhe destinim ekonomik me reagjentët dhe materialet shpenzuese.

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë asnjë analizë individuale të këtyre kontratave dhe nuk ka shpjeguar se në çfarë mënyrë furnizimi me një pajisje laboratorike apo minicentrifugë konsiderohet kontratë e ngjashme me furnizimin me reagjentë dhe materiale shpenzuese. Në vend të një vlerësimi objektiv, AK është mjaftuar me deklarimin se kontratat janë “të përafërta”, pa përcaktuar kriteret teknike, funksionale apo profesionale mbi të cilat është bazuar ky përfundim.

Fakti se një pajisje përdoret në laborator nuk e bën automatikisht furnizimin me atë pajisje të ngjashëm me furnizimin me reagjentë laboratorikë. Një interpretim kaq i gjerë do ta zhvlerësonte tërësisht kërkesën për kontrata të ngjashme dhe do të lejonte që çdo furnizim i lidhur në mënyrë të përgjithshme me laboratorët të konsiderohej përvojë e përshtatshme, pavarësisht natyrës së mallrave të furnizuara.

2. Janë pranuar kontrata të përfunduara pas publikimit të Njoftimit për Kontratë

Njoftimi për Kontratë është publikuar më datë **05.05.2026**. Megjithatë, në listën e OE të rekomanduar janë përfshirë edhe kontrata të përfunduara pas kësaj date, përkatësisht:

- Kontrata nr. 5, me datë përfundimi **17.06.2026**;
- Kontrata nr. 8, me datë përfundimi **26.05.2026**.

Këto kontrata nuk kanë qenë të përfunduara në datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohen si kontrata të përfunduara me sukses brenda periudhës referente të kërkuar nga dosja e tenderit.

Në vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me këtë pretendim. AK vetëm ka mbledhur vlerën nominale të të gjitha kontratave të listuara, pa verifikuar nëse secila kontratë ka qenë e përfunduar dhe e pranueshme në momentin relevant për vlerësimin e aftësisë teknike dhe profesionale.

Mosadresimi i këtij pretendimi përbën mangësi thelbësore të vendimit, sepse data e përfundimit të kontratave ndikon drejtpërdrejt në përmbushjen ose mospërmbushjen e pragut prej 40,000.00 euro.

3. Vlera e kontratave të pranueshme nuk e arrin pragun prej 40,000.00 euro

Pas përjashtimit të kontratave që nuk përkojnë me natyrën e kërkuar dhe të kontratave të përfunduara pas datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë, mbeten vetëm kontratat nr. 1, 3 dhe 6, me vlerë të përgjithshme:

- Kontrata nr. 1: **7,800.00 euro**;
- Kontrata nr. 3: **6,000.00 euro**;
- Kontrata nr. 6: **15,000.00 euro**;
- Gjithsej: **28,800.00 euro**.

Kjo shumë është dukshëm nën pragun minimal prej **40,000.00 euro** të kërkuar në dosjen e tenderit. Për më tepër, edhe këto kontrata janë kontrata të përziera, të cilat përfshijnë pajisje dhe reagjentë. Prandaj, për qëllime të përmbushjes së kriterit, duhej të merrej parasysh vetëm vlera që i përket furnizimit me reagjentë dhe materiale të ngjashme, jo vlera e plotë e pajisjeve. Në këtë rast, vlera e pranueshme do të ishte edhe më e ulët se 28,800.00 euro.

AK nuk e ka kundërshtuar këtë përlllogaritje me ndonjë analizë konkrete. Në vendim nuk është paraqitur se cilat kontrata dhe cilat vlera janë llogaritur për arritjen e shumës prej 64,200.00 euro, cilat kontrata janë konsideruar të ngjashme, si dhe nëse është verifikuar pjesa konkrete e furnizimeve që lidhet me objektin e LOT 2.

Konstatimi se vlera totale e listës është 64,200.00 euro nuk është i mjaftueshëm, pasi lista e kontratave nuk mund të pranohet në mënyrë mekanike. Secila kontratë duhet të vlerësohet veçmas në raport me natyrën, periudhën e realizimit, përfundimin e suksesshëm dhe vlerën që lidhet me furnizimet e ngjashme.

4. Diferenca në çmim nuk mund ta bëjë të përgjegjshme një ofertë që nuk i plotëson kriteret

Në vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues ka theksuar se oferta e OE CORTEX është në vlerë prej **14,250.00 euro**, ndërsa oferta jonë është në vlerë prej **29,550.00 euro**, duke e përdorur këtë diferencë si argument për refuzimin e kërkesës sonë.

Ky arsyetim është juridikisht dhe proceduralisht i gabuar. Kriteri i çmimit më të ulët zbatohet vetëm ndërmjet ofertave që paraprakisht janë konstatuar si të përgjegjshme dhe që i plotësojnë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Një çmim më i ulët nuk mund ta kompensojë mungesën e aftësisë teknike dhe profesionale dhe nuk mund ta shndërrojë një operator të papërgjegjshëm në operator të përgjegjshëm.

Prandaj, para krahasimit të çmimeve, AK ka qenë i obliguar të verifikojë nëse OE i rekomanduar e plotëson kriterin prej 40,000.00 euro në kontrata të ngjashme. Vetëm pas këtij verifikimi mund të zbatohet kriteri për dhënien e kontratës.

5. Vendimi i AK-së nuk i trajton në mënyrë të plotë pretendimet ankimore

Vendimi i kontestuar nuk përmban analizë të veçantë për secilin pretendim të ngritur në kërkesën tonë për rishqyrtim. Konkretisht, AK nuk ka sqaruar:

- pse kontratat për pajisje laboratorike dhe minicentrifugë janë konsideruar të ngjashme me furnizimin me reagjentë dhe materiale shpenzuese;
- pse janë marrë parasysh kontratat e përfunduara pas datës 05.05.2026;
- cilat kontrata dhe cilat vlera konkrete e përbëjnë shumën prej 64,200.00 euro;
- nëse kontratat e përziera janë analizuar sipas vlerës së reagjentëve apo sipas vlerës së përgjithshme;
- si është konstatuar se referencat dhe certifikatat e pranimit i mbështesin plotësisht vlerat e deklaruara në listë.

Për rrjedhojë, vendimi nuk përmban arsyetim të plotë, të verifikueshëm dhe të mbështetur në prova, por vetëm konstatime të përgjithshme.

6. Komenti i AK-së lidhur me ushtrimin e ankesës është i papërshtatshëm

Në vendimin e tij, AK ka kërkuar nga ne që “me mirëkuptim të mos bëjmë ankesa të tilla”, me arsyetimin se ankesat shkaktojnë vonesa në procedurë.

Ky koment është i papërshtatshëm dhe nuk përkon me detyrimin e Autoritetit Kontraktues për trajtim objektiv dhe të paanshëm të kërkesave për rishqyrtim. Ushtrimi i kërkesës për rishqyrtim dhe i ankesës pranë OSHP-së është e drejtë ligjore e operatorit ekonomik dhe nuk mund të paraqitet si pengesë apo vonesë e panevojshme, veçanërisht kur janë ngritur pretendime konkrete dhe të mbështetura në dokumentacion.

Fakti se oferta e rekomanduar ka çmim më të ulët nuk e cenon të drejtën tonë për të kërkuar kontrollin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit dhe nuk e liron AK-në nga obligimi për t’iu përgjigjur në mënyrë profesionale dhe të argumentuar pretendimeve të paraqitura.

Dispozitat e shkelura

Me veprimet dhe mosveprimet e përshkruara më sipër, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur:

- **Nenin 7 të LPP-së**, lidhur me barazinë në trajtim dhe mosdiskriminimin;
- **Nenin 59 të LPP-së**, lidhur me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve;
- **Nenin 60 të LPP-së**, lidhur me kriteret për dhënien e kontratës;
- **Nenin 69 të LPP-së**, lidhur me aftësinë teknike dhe/ose profesionale.

Kërkesa drejtuar OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, provat dhe argumentet e paraqitura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. Ta aprovojë si të bazuar ankesën e OE **Interlab SH.P.K.**;
2. Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës **07.07.2026**, përmes të cilit është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim;
3. Ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës **29.06.2026** për LOT 2;
4. Ta kthejë aktivitetin e prokurimit për LOT 2 në rivlerësim;
5. Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të verifikojë veçmas natyrën, periudhën, përfundimin dhe vlerën e secilës kontratë të paraqitur nga OE **CORTEX Healthcare L.L.C.**;
6. Të konstatojë se kontratat që nuk janë të ngjashme me objektin e LOT 2 dhe kontratat e përfunduara pas publikimit të Njoftimit për Kontratë nuk mund të përdoren për përmbushjen e kriterit prej 40,000.00 euro;
7. Të konstatojë se OE **CORTEX Healthcare L.L.C.** nuk e ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të aftësisë teknike dhe profesionale dhe, rrjedhimisht, oferta e tij duhet të trajtohet si e papërgjegjshme;
8. Pas eliminimit të ofertës së papërgjegjshme, AK ta vazhdojë vlerësimin dhe dhënien e kontratës në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet procedurale per tender!

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*